

31 personalitete nga bota dhe Shqipëria, të intervistuar nga Gjekë Marinaj

"Ana tjetër e pasqyrës", shënime mbi librin me intervista të poetit Gjekë Marinaj

nga Arben Çokaj

Poeti Gjekë Marinaj ka fituar elasticitet në punën e tij krijuese. Në mënyrë krejt natyrale ai zgjatet nga poezia të gazetaria dhe anasjelltas. Me pyetjet e tij kurioze drejtuar për personalitete me famë botërore e shqiptare të artit e letërsisë, politikës dhe sportit, të sjellë para lexuesit shqiptar një libër me intervista sa interesant aq edhe domethënës. Marinaj fokusohet mbi tre fusha të ndryshme të marëdhënies shoqërore, të cilat në plan të parë nuk duket se kanë shumë lidhje me njëra-tjetrën, por që padyshim ndikojnë në ndërgjegjen shoqërore, emocionet, pasionin dhe ndjenjat e njerëzve, hapësirën e mendimit dhe forcën konceptuale, bukurinë estetike apo tingullin esencial të një vargu, secila më shumë apo më pak se tjetra.

Politika, Sporti dhe Poezia. Një simbiozë tredimensionale me kahje diverse të shkruara në një libër, që kur e përfundon së lexuari, ndjen një shije të këndshme, pasi je njohur më mirë me disa figura të suksesshme, të shtrira në një

sipërfaqe që mbulon globin. Janë 31 personalitete të intervistuar, ndër të cilët në politikë mund të përmendim ish-presidentin Xhorxh Bush, ish-presidentin Sali Berisha, kryetarin e Partisë Republikane Fatmir Mediu, publicistin, botuesin dhe politikanin Nikollë Lesi, ish-kryeministrin izraelit dhe fitues i çmimit Nobel për paqe Shimon Perez, ish-deputetin e ndjerë Dodë Kaçaj, dhe për të përfunduar me politikanin kosovar të kohës së ish-Jugosllavisë Azem Vllasi.

Me këto intervista, Marinaj ka dashur të eksplorojë mundësitë që i jepen një populli për të administruar vetveten përmes politikës, faktorët që çojnë në mbijetesën e një kombi, hapësirat, kuptueshmërinë, si dhe mirëqënien shoqërore në përgjithësi, që jep një regjim i lirë e demokratik, përkundër regjimeve totalitare.

Intervistat letrare, Marinaj i fillon me poetin tonë të shquar Dritëro Agolli, të cilin siç shihet e ka për zemër. Marinaj e përdor poezinë jo vetëm si art i të shprehurit të saj në një mënyrë sa më koncize të ndjenjës, mendimit filozofik apo forcës emocionale, por edhe si ushqip shpirtëror, të cilës i

referohet herë-pas-herë, ku merr edhe pjalmin e bukur të ngjizjes së ideve të reja. Ai i referohet vargjeve të Agollit "Kur të jesh mërziur shumë/ në raft të librave kërkomë..." etj. etj. që tregon edhe forcën shlodhëse të një poezie të bukur dhe përjetshme e saj në melodinë e brendshme të njeriut. Pasonjë më pas intervistat me shkrimtarë dhe poetë si Ismail Kadare, Naum Prifti, Agim Shehu, Anton Çefa, Shefqet Dibrani, Skifter Këlliçi, etj. të cilët së bashku me autorë të tjerë të talentuar, i japin librit një përqindje të lartë vlerash artistike, ku flitet padyshim edhe për vështirësitë e krijuesve shqiptarë nën kazmën e rëndë të realizmit socialist.

Marinaj i ka kushtuar një vëmendje të veçantë në libër atdhetarit të madh dhe me famë nga Malësia e Madhe, Prenkë Gruda, autor i librit "Ditari i një zemre të lëndueme", të cilin e ka vizituar në shtëpinë e tij në Florida, vetëm pak muaj para se ai të mbyllte sytë në lumnimin e tij të përjetshëm. Ndonëse i lodhur nga sëmundja e rëndë, Prenka i hipën makinës së tij dhe nis për në bregdet, bashkë me autorin e librit në

fjalë: "Shikoje detin! Nuk është i turbullt se është i thellë - i thotë ai Gjekës - Cektësia i turbullon gjërat. Matu me detin kur shkruan... duaje njëriun dhe Shqipërinë sa do ky det bregun! Ky është peshqeshi im, që kam për ty." Pa këto fjalë filozofike të një atdhedashurie të nevojshme për ne shqiptarët në këto kohë, libri mund të kishte qenë më i mangët. Në fakt, libri me intervista të Gjekë Marinajt përshkruhet gjatë gjithë kohës nga një fill i hollë i një atdhedashurie të kuptueshme.

Marinaj prodhon art duke ndërthurur karaktere të ndryshme, që i përkasin fushave dhe pasioneve të ndryshme. Kot nuk pyesin "Ku e ke shtëpinë?", "Tek fshati i gruas..." është përgjigjia. Edhe Marinaj në këtë rast nuk i ka shpëtuar ketij orientimi instiktiv, kësaj përkujdesjeje xhentile, që ai tregon për gjysmen e bukur të tij, bashkëshorten romune. Dusita Marinaj, së cilës autori ia përkushton librin me shumë dashuri, ka në familjen e saj të afërt një futbollist romun me famë, Millodrag Bellodediç, me të cilin fillohen edhe intervistat me personalitetet e sportit shqiptar dhe botëror. Kemi këtu një



Ballina e librit "Ana tjetër e pasqyrës"

larmishmëri personalitetesh sportive, duke përfshirë futbollistin tironas Sulejman Demollari, apo intervistën me yllin e futbollit botëror Pele, për ta mbyllur me legendën e futbollit kosovar Fadil Vokrrin.

Duket qartë se idenë për të bërë një libër të tillë, Marinaj e ka bluar në kohë. "Ana tjetër e pasqyrës", që ka dalë në qarkullim para pak kohësh nga shtëpia botuese Marinaj Publishing në Dallas, është shpërndarë tashmë në libraritë dhe bibliotekat shqiptare, ashtu edhe në disa vende të ndryshme të botës.

Në Shqipëri dhe Kosovë libri ka një çmim simbolik, në krahasim me çmimin e tij real të botimit cilësor dhe çmimin e shitjes jashtë shteti, të cilin po ia lëmë lexuesit ta zbulojë vetë.

Pas titullit të librit dhe hyrjes së shkruar nga autori, intervistat shoqërohen me një sqarim të shkurtër hyrës, ku lexuesi njihet shkurtimisht me të intervistuarin, i cili më pas bëhet më i dukshëm përmes intervistës së drejtëpërdrejtë.

"Ana tjetër e pasqyrës" simbolizon pjesën e padukshme të një karakteri, çfarë fshihet pas një personaliteti me famë, pas një krijuesi të talentuar, apo pas një njeriu të njohur nga të gjithë? Këtë trilli interesant e kurioz njëherësh, Gjekë Marinaj ka provuar t'i japë përgjigje, përmes pyetjeve të tij dhe fjalëve të të intervistuarve. Me pak fjalë: një libër që ia vlen të lexohet!

"Nderi" i vonuar i Petro Markos

Edhe pse është konsideruar gjithmonë si i tillë, tashmë do të quhet ligjërisht "Nderi i Kombit". Në datën 5 dhjetor, Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, do t'u dorëzojë të afërmëve të shkrimtarit Petro Marko, titullin e lartë. Edhe pse titujt që kreu i lartë i shtetit akordon nuk kanë ndonjë kut se kur dhe kush i meriton këto dekorata dhe urdhra nderi, askush nuk do të besonte se zoti Moisiu që për një periudhë kohe siç ndodhi vitin e kaluar ka arritur të japë edhe 1 titull në 48 orë, të ketë prituri për fenomenin "Petro Marko" që vepra e tij të kryejë ciklin e plotë të botimeve dhe kur lexuesi shqiptar të mirrte për herë të parë në duar vepra të pabotuara apo të ndalura në kohën e diktaturës komuniste. Kreu i shtetit, vendos që ta dekorojë me urdhrin "Nderi i Kombit", për kontributin që ka dhënë jo vetëm në letërsinë shqiptare, por edhe gjatë luftës kundër fashizmit. Gjatë viteve të diktaturës komuniste, vepra e Petro Markos, është censuruar, për shkak të frymës rebelë që mbizotëronte në faqet e librave të tij. Shumë syresh u ndalu-



Petro Marko

an, të tjerë dolën në treg dhe tërhoqën sërish, për t'u "djegur në turrën e druve".

Është një nderim i vonuar ky që po i bëhet Markos, aq më tepër kur motivi nga presidenca flet për kontribute të mirëqena të shkrimtarit humanist. Ashtu sikur edhe institucione të tjera

kanë qenë të vonuar me Markot. Rasti i Ministrisë së Kulturës e cila vetëm para pak kohësh sponsorizoi më në fund për botimin e një vepre të panjohur.

Gjatë 10 vjetëshit të fundit të shekullit të kaluar, por kryesisht në shekullin e ri, janë botuar shumë libra të Markos. Vetëm gjatë viteve '99-2003, Shtëpia Botuese "OMSCA" ka botuar 12 vepra, romane dhe përmbledhje tregimesh. Pesë prej këtyre veprave kanë qenë të pabotuara më parë, ndërsa të tjerat janë botime të dorëshkrimeve origjinale të autorit. Disa nga botimet më të fundit janë "Tregime të zgjedhura", "Stina e armëve", etj, të cilat janë prituri mjaft mirë nga publiku. Sipas botuesit Luan Pengjili, vitin që vjen do të dalin në dritë dhe dy vepra të tjera të Petro Markos, njëra prej së cilës është e pabotuar më parë.

Me rastin e dhënies së titullit "Nderi i Kombit", ditën e premte, do të shfaqet dhe premiera e filmit dokumentar "Petro Marko, një gur në vendin e vet", i regjisorit Namik Ajazi. Ky film dokumentar prej 42 minutash, me skenar të së bijës së shkrimtarit, Arianita Marko

dhe Namik Ajazit, rrëfen për jetën dhe veprimtarinë e Petro Markos, prej viteve të para të jetës së tij, deri në momentin e lamtumirës. Dokumentari është ndërtuar mbi bazën e rrëfimeve, jo vetëm të atyre njerëzve që e kanë njohur personalisht Petron, apo që kanë jetuar me të, por edhe atyre që e kanë njohur nëpërmjet veprës së tij. Ndërsa kamera do të shëtisë nëpërvendin e tij të lindjes, në Dhërmi, në gurët, kalldrëmet dhe valët e detit, do të jenë 12-13 personazhe që do të tregojnë për jetën dhe veprimtarinë e shkrimtarit. Mes këtyre dëshmitarëve do të jenë edhe dy shtetase të huaja, njëra italiane dhe tjetra spanjolle. Kjo e fundit e ka njohur Petro Markon vetëm nëpërmjet përkthimit të veprës së tij "Hasta la vista" në gjuhën spanjolle. Ky dokumentar është realizuar falë financimit nga Qendra Kombëtare Kinematografike dhe mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Bankës Italo Shqiptare dhe Bashkisë së Tiranës. Ceremonia e dhënies së dekorimit të shkrimtarit do të zhvillohet ditën e premte në orën 11.00, në sallën e Teatrit Kombëtar.

(Shekulli)

Ana tjetër

DIASPORA / PËRKUJTIME

BOTA SOT 9 nëntor 2003

19



Në librin me intervista „ANA TJETËR E PASQYRËS“ të Gjekë Marinajt, janë përfshi 31 personalitete të shquara të politikës, letërsisë, artit, muzikës e sportit shqiptarë e botëror, në mesin e të cilëve: George Bush, Shimon Peres, Sol Laurie, Sali Berisha, Fatmir Mediu e ndonjë tjetër, nga letërsia janë intervistat me Ismail Kadaren, Prenkë Grudën, Dritëro Agollin, Petër Priftin, Shefqet Dibranin, Agim Shehun, Adnan Mehmetin etj., kurse nga letërsia botërore veçojmë intervistën me shkrimtar skocez James Kelman.

VITRINA E LIBRIT

ANA TJETËR E PASQYRËS

Gj.Marinaj ka intervistuar edhe shumë sportistë në mesin e të cilëve është mbreti botëror i futbollit Pele, pastaj futbollistin rumun Belledediç, tetovari Bruno Ceka, Kujtim Majaci, Fadil Vokri etj, poashtu në këtë libër janë përfshirë edhe intervista me Afërdita Zonja-këngëtare, Astrit Tota- piktor si dhe me një varg emrash të njohur që kanë një shtrirje më të gjerë se sa kufijtë etnik.

Në fund të muajit tetor të këtij viti në Texas të Amerikës doli nga shtypi libri me intervista i poetit Gjekë Marinaj, libër që e botoi Shtëpia Botuese "Marinaj Publishing". Autori i librit në fjalë deri më tani ka botuar dy libra me poezi: "Mos më ik larg", Tiranë 1995 dhe "Infinit" USA 2002. Po ashtu Marinaj vite më parë ka botuar revistën kulturore "Kohët e poetëve", kurse tani është njëri nga drejtuesit e revistës "PENA", organ i Shkrimtarëve Shqiptarë në Amerikë. Libri më i ri që përmban 31 intervista është një kontribut i këtij autori edhe në fushën e shkrimeve publike ku ka arritur të bëjë intervista të shumta me per-

sonalitete të njohura të jetës publike qofshin këta letrarë, piktorë, këngëtar, politikanë apo sportist. Librin e shoqëron një fjalë hyrse e autorit, kurse radhëja e të intervistuarve i nënshtrohet kruterit të rënditjes sipas alfabetit. Secila intervistë shoqërohet që në fillim me një shënim hyrës të autorit jo aq si parapërgatitje për intervistë por më shumë del si ndjenjë e hollë përkushtimi që ka Gj.Marinaj për të gjithë emrat publikë të intervistuar nga ai. Është interesante se intervistat nuk mbajn tituj e as mestituj, vetëm emrin e intervistuesit duke e lënë lexuesin të gjkoj pas leximit të secilës intervistë dhe nuk janë kategorizuar sipas zhanërve të veprimtarisë së tyre.

Botimi i librit është ndihmuar nga Tonin Marinaj dhe këngëtari David Stanaj, e botoi Shtëpia Botuese „Marinaj Publishing“ Richardson-Teksas USA, tetor 2003. faqe 260. ISBN 0-9728521-2-3. MP-Numri i Librarisë së Kongresit: 05-2667-2003-03, çmimi 21.95\$. Sh. B. "Marinaj Publishing", P.O. Box 833213. Richardson, TX 75083 USA. /SH. D.



kujton e mban si idhull.

Të përkujtojnë: nëna Tone, vëllezërit Tushi dhe Marjani, motrat, nipat, mbesat dhe të gjithë ata që i kishë për zemër.

E PAME

Vëllezërit Sokoli, Rifati, Nexhati, Xhevati hapin të pamen për babain XHEMAJL cen BATUSHA nga fshati Baballoq Deçan dhe njoftojmë të afërmit, miqtë dhe dashamirët të dielën me datën 09.11.2003 prej orës 08-18 në Leibstadt rruga kryesore te Atom Kraftwerk KKL (Centrali bërthamor) info. tel, 078 834.03.38 (Sokoli) dhe 078.881.90.86 (Xhevati) familja Batusha.

TURNIR FUTBOLLI

Lajmërohen dashamirët e futbollit se KF „Liria“ organizon turnir në futboll të vogël në sallë në Kerzers. Turniri mbahet me datën 07.12.2003. Ekipet mund të paraqiten deri me datën 04.12.2003. Numri i ekepeve është i kufizuar në 24 ekepe. Paga për ekip është 100 sfr dhe loja luhet në sistemin 5+1. Për paraqitje të ekepeve lajmërohuni në tel: Njazi Gashi: 079-5097327, Nevruz Krasniqi: 079-4444113, Sejdi Rudaj 076-4090437, Binak Krasniqi. 076-4321705.

Me nderime KF „Liria“ dhe organizatorët

SHËNIM

"ANTOLOGJI E POEZISË MODERNE SHQIPE"